- Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik sipas legjislacionit të tillë;
- Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të agjencive donatore, të kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare, punën e rindërtimit, administratën civile apo ndihmën teknike në Kosovë;

Të ardhurat që përjashtohen (vazhdon)

- Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike;
- Rrogat e personelit të jashtëm të KFOR-it dhe EULEX-it;
- Kompensimet për dëmtimin ose shkatërrimin e pronës;
- Të ardhurat nga polisat e sigurimit të jetës që paguhen si rezultat i vdekjes së personit të siguruar;
- Kompensimi për trajtimin mjekësor dhe shpenzimet, duke përfshirë edhe hospitalizimin dhe mjekimin, pos rrogave të paguara gjatë periudhës së mungesës nga puna për shkak të sëmundjes ose lëndimit;

Të ardhurat që përjashtohen (vazhdon)

- Pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori;
- Pagesat e pensioneve dhe asistencat sociale të paguara nga Qeveria e Kosovës;
- Shpenzimet edukativo arsimore që punëdhënësi paguan të punësuarit me kusht që shpenzimet të jenë paguar drejtpërdrejt në institucionin arsimor dhe me kusht që i punësuari të mbetet edhe për 24 muaj në punë te punëdhënësi pas përfundimit të shkollimit;
- Bursat e marra nga një individ, por me kusht që të paguhet drejtpërdrejt në institucionin edukativo arsimor;
- Shpenzimet e trajnimit.

Të ardhurat që përjashtohen (vazhdon)

- Përfitimet për dëmshpërblime të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;
- Të ardhurat në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë;
- Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar për ish të dënuarit politik si dhe kompensimet tjera për kategori të ngjashme;
- Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Dividenda e pranuar nga personi rezident dhe jo-rezident;

Të ardhurat nga pagat

Në të ardhurat bruto nga pagat, **përfshihen**:

- **Rrogat e paguara** në emër të një punëdhënësi për punën të cilën e kryen punonjësi sipas udhëheqjes së drejtorit ose punëdhënësit;
- **Bonuset, provizionet, meditjet dhe format e tjera të kompensimit** që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës;
- Të ardhurat e fituara nga **puna e përkohshme** të cilën e kryen punonjësi;
- Të ardhurat nga punësimi i mundshëm, siç është **nënshkrimi i një bonusi të rrogës**;

Të ardhurat nga pagat (vazhdim)

- **Premitë e sigurimit shëndetësor dhe të jetës** që një punëdhënës paguan për punonjësin;
- **Falja e huas së punonjësit** ose e obligimit të punëdhënësit;
- **Pagesa e shpenzimeve personale** të punonjësit nga punëdhënësi dhe
- Pos nëse përcaktohet ndryshe me Ligjin për TAP, përfitimet në gjësende që një punëdhënës ia jep punonjësit që kalon shumën minimale mbi 65€.

Të ardhurat bruto nga paga

Në të ardhurat bruto nga paga **nuk përfshihen**:

- Kompenzimi i shpenzimeve reale të udhëtimit të biznesit ku përfshihen transporti, ushqimi dhe fjetja për udhëtime zyrtare;
- Transporti – 16 cent për/ km brenda Kosovës, jashtë Kosovës nuk ka limit por vetëm bileta, e gatshme për inspektim;
- Shujta – 15€ brenda dite dhe 25€ nëse nata kalohet në Kosovë, ndërsa për udhëtime jashtë Kosovës, konform Udhëzimit Administrativ të MAP Nr. 2004/07;
- Fjetja - brenda Kosovës 50€, ndërsa jashtë Kosovës bazuar në UA të MAP;

Të ardhurat bruto nga paga

Në të ardhurat bruto nga paga **nuk përfshihen** :

- Dëmshpërblimi për aksidente në punë;
- Kontributet e dhëna nga punëdhënësi në emër të punonjësit;
- Përfitimet në natyrë në formë të shujtave;
- Përfitimet në natyrë në formë të biletave (>1 kilometër);
- Kompensimi për vajtje ardhje në punë (>20 kilometër);

Tatimpaguesit në të Ardhurat nga Pagat

- Të gjithë individët, rezidentë dhe jo-rezidentë, që fitojnë të ardhura nga pagat në Kosovë, do të konsiderohen të punësuar dhe janë të obliguar të paguajnë tatim në të ardhurat personale nga pagat, përveç të punësuarave të huaj në trupat e përcaktuara në Ligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale në Kosovë.

Hapat që duhet të ndërmerren për aplikimin e TAP nga Pagat

Kontratat e punëtorëve

- Për secilin punëtor, punëdhënësi duhet t'i ketë kontratat e nënshkruara nga punëdhënësi dhe i punësuari. Në kontratë përcaktohet pozita e punës, detyrat e punës, data e fillimit, afati i punës, kompenzimi, detyra tjera në bazë të marrëveshjes, etj.

Regjistrimi i të punësuarit

- Punëdhënësi, përmes deklarimit të listës së pagesës mujore në formatin elektronik të përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, cakton se i punësuari ka përzgjedhur atë si punëdhënës kryesor apo jo;

- Punëdhënësit, të cilët nuk janë të përzgjedhur si punëdhënës kryesor nga i punësuari i tyre, do të trajtohen si punëdhënës sekondar për çështjet tatimore.

Tatimi i mbajtur në burim në paga

- **Pagat** zakonisht paguhen një herë, dy herë ose edhe më shumë herë në muaj.

- **Zbritja** pranohet në të njëjtën periudhë tatimore.

- **Ndalja e tatimit në burim** - lind vetëm kur pagat në të vërtetë janë paguar.

Tatimi në paga

- Punëdhënësi kryesor duhet të llogaris (për çdo muaj të mbajë tatimin në burim në paga) dhe të paguaj tatimin sipas grupimeve të pagave dhe shkallëve tatimore të dhëna në tabelën në vijim:

Shkallët tatimore mujore		Të ardhurat e tatueshme	Përqindja e tatimit	Tatimi mujor
1	2	3 (2-1)	4	5 (3 x 4))
0.00	80.00	80.00	0%	0.00
80.00	250.00	170.00	4%	6.80
250.00	450.00	200.00	8%	16.00
450.00	Mbi	0.00	10%	0.00
Gjithsej vlera e tatimit				

- Punëdhënësi sekondar duhet të llogaris (për çdo muaj të mbajnë tatimin në burim) dhe të paguaj tatimin, vetëm me shkallën maksimale **10%**.

Deklarimi i Tatimit në Paga

- Deklarimi i Tatimit në Paga bëhet vetëm përmes Sistemit Elektronik - EDI, përmes ueb-faqes së ATK-së.
- Pagesa e Tatimit në Paga dhe Pensione duhet të paguhet përmes fletëpagesës së gjeneruar nga Sistemi EDI.
- Pagesa mund të bëhet fizikisht apo përmes E-Banking, në një nga bankat / institucionet e autorizuara në Kosovë.
- Tatimi duhet të paguhet tërësisht në të njëjtën kohë, kur edhe ndalet në burim.

Kontributet Pensionale

- Punëdhënësi (si ai primar ashtu edhe ai sekondar) duhet të kontribuojë 5% në pagën bruto të punëtorit në emër të punëtorit.
- Punëdhënësi duhet të ndalë në burim edhe 5% nga paga bruto e punëtorit, dhe t'i paguajë ato menjëherë në formë të kontributeve pensionale.
- Që të dy, si punëdhënësi ashtu edhe punëtori, mund të ngritin vullnetarisht shumën e kontributit edhe për 10%.
- Kontributi i kombinuar, pra, përqindja e punëtorit dhe punëdhënësit, nuk mund të jetë më e vogël se 10%, por as më e madhe se 30%.

Kontributet Pensionale

- Vetëm kontributi **i të punësuarit** do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore nga paga e tij / saj.
- Ndërsa kontributi i punëdhënësit do të jetë shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore të punëdhënësit.
- Kontributi Pensional minimal (5% + 5%), duhet të paguhet në FKPK, ndërsa kontributet plotësuese pensionale, mund të paguhen në FKPK apo në ndonjë fond tjetër të licencuar nga BQK.

Shembull - përllogaritja e pagës

I punësuri “X”					
Paga Bruto			**450.00**		
Kontributi nga i punësuari			22.50	5%	
Kontributi nga punëdhënësi			22.50	5%	
Gjithsej kontributi pensional			45.00		
Paga bruto			450.00		
Kontributi nga i punësuari			22.50		
Paga e tatueshme			427.50		
	A	B	C=B-A	D	E=CxD
G1	0.00	80.00	80.00	0%	0.00
G2	80.00	250.00	170.00	4%	6.80
G3	250.00	427.50	177.50	8%	14.20
Tatimi ne paga G1+G2+G3					**21.00**

I punësuri “Y”					
Paga Bruto			**600.00**		
Kontributi nga i punësuari			30.00	5%	
Kontributi nga punëdhënësi			30.00	5%	
Gjithsej kontributi pensional			60.00		
Paga bruto			600.00		
Kontributi nga i punësuari			30.00		
Paga e tatueshme			570.00		
	A	B	C=B-A	D	E=CxD
G1	0.00	80.00	80.00	0%	0.00
G2	80.00	250.00	170.00	4%	6.80
G3	250.00	450.00	200.00	8%	16.00
G4	450.00	570.00	120.00	10%	12.00
Tatimi ne paga G1+G2+G3+G4					**34.80**

Libri i pagave mujore

Emri	Mbiemri	Numri Individual i punëtorit	Bruto paga për muaj	Kontributi pensional i të punësuarit	Kontributi pensional i punëdhënësit	Kontributi suplementar i të punësuarit	Kontributi suplementar i punëdhënësit	Punë Primare	Përfshihen Kontributet	Aplikohet Tatimi në Paga
a	b	c	d	e=(d*5%)	f=(d*5%)	g	h	i	j	k

Deklarimi dhe pajisja me Çertifikatë

- Çdo person i cili paguan paga është i obliguar që deri në ditën e 15 të muajit pasues të bëjë deklarimin dhe pagesën e tatimit në paga.
- Çdo person që mban tatimin në burim në paga gjatë një periudhe tatimore, me kërkesë të pranuesit të të ardhurave, është i obliguar të pajis të njëjtin me certifikatën e tatimit të mbajtur në burim, në formën e specifikuar nga ATK.

Mbajtja në burim në pagesa për jo-rezidentët

- Të ardhurat që i atribuohen një jo – rezidenti në Kosovë, si një zbavitës, sikurse është teatri, figurat e lëvizshme, artistë radioje apo televizioni, këngëtar apo ndonjë muzikant, sportist, i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim nga paguesi i tij.
- Përveç këtyre, mbajtjes në burim i nënshtrohen edhe personat apo entitetet jo-rezidente që nuk kanë njësi të përhershme në Kosovë.
- Shkalla e mbajtjes në burim është **5%**
- Përjashtim nga të ardhurat e mësipërme, të ardhurat e realizuara nga personi jo-rezident, i cili trajtohet i punësuar në Kosovë, tatimohen sipas nenit 38 të Ligjit për TAP.

Mbajtja e tatimit në burim

- Të gjithë personat fizik afarist dhe personat juridik, se janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim për pagesat që i bëjnë për: paga dhe pensione, interes, të drejta pronësore, qira, kategori të veçanta dhe për pagesa të caktuara për jo rezidentë, ashtu siç është përcaktuar në Legjislacionin Tatimor.

Mbajtja në burim në pagesa për jo-rezidentët

- Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e paguara për jo-rezidentët ka të bëjë me pagesat për shërbimet e kryera në Kosovë.

- Nuk kërkohet mbajtja e tatimit në burim në pagesat e bëra për jo-rezidentët për mallra ose nga pagesat e bëra për jo-rezidentët për shërbimet e kryera jashtë Kosovës (për shembull shërbimet për mbështetjen e sistemit kompjuterik të siguruar nga distanca nga një vend tjetër).

Të ardhurat personale nga aktivitetet afariste

- Të ardhurat bruto nga veprimtaritë afariste nënkupton pranimet bruto të gjeneruara nga një person apo entitet, përveç personave juridik për qëllime të këtij ligji, të angazhuar në veprimtari të tilla.
- Bizneset me të ardhura vjetore bruto >50,000€, apo ata të cilët zgjedhin të mbajnë libra dhe regjistrime sipas tatuerjes në të ardhura reale, të ardhurat duhet të raportohen në periudhën tatimore gjatë së cilës janë pranuar apo akruar (lindur).
- Bizneset me të ardhura vjetore bruto <50,000€ e më pak, do të raportojë të ardhurat nga veprimtaritë afariste në periudhën tatimore në të cilën ato të ardhura në të vërtetë apo në mënyrë konstruktive janë pranuar.

Të ardhurat nga qiraja

Si të ardhura tjera nga aktiviteti afarist janë edhe të ardhurat nga qiratë. Të ardhurat bruto nga qiratë përfshijnë:

- Të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pasurisë së patundshme si: ndërtesat, toka ose apartamentet.
- Të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pajisjeve, automjeteve të transportit dhe llojeve tjera të pasurisë.
- Të ardhurat e qirasë të krijuara nga personat e angazhuar në veprimtari ekonomike të dhënies me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme për klientët, do të trajtohen si të ardhura nga aktivitetet ekonomike.
- Norma e tatimit për te ardhurat nga qiratë është 10%.

Të ardhurat nga pasuria e paprekshme

- Të ardhurat nga pasuria e paprekshme janë një grup i të ardhurave nga pasuritë të cilat nuk kanë formë fizike (nuk janë të prekshme). Këto lloje të pasurive kanë te bëjnë kryesisht me të drejta. Çdo e drejtë për të shfrytëzuar pasurinë e paluajtshme është e paprekshme.
- Të ardhurat bruto nga pasuria e paprekshme përfshijnë të ardhurat e krijuara nga:
  - Patentat
  - Të drejtat autoriale,
  - Licencat
  - Të drejtat ekskluzive dhe pasuritë tjera që përbëhen vetëm nga të drejtat dhe që nuk kanë formë fizike.

Të ardhurat nga Interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë:

- Interesin nga huat e dhëna për personat apo entitetet;
- Interesin nga flet obligacionet ose letrat tjera me vlerë të lëshuara nga organizatat afariste;
- Interesin nga llogaritë (e kursimeve) të cilat sjellin interes e që mbahen në banka dhe në institucione të tjera financiare.

Të ardhurat e tjera përfshirë dhuratat

- Të ardhurat nga dhuratat përfshijnë:
  - Të ardhurat nga fitoret në lotari apo të ardhurat nga faljet e borxheve.
  - Dhuratat në para apo gjësende të pranuara nga rezidentët nëse dhuratat e tilla tejkalojnë shumën 5.000 € në një periudhë tatimore.
- Në grupin e të hyrave nga dhuratat kemi edhe disa të hyra/dhurata të cilat janë te liruara nga TAP si:
  - Dhuratat (qofshin në para apo në gjësende) të dhëna në mes bashkëshortëve apo nga një prind fëmijës së tij natyror, apo ligjërisht të adoptuar, apo nga fëmijët prindërve të tyre, janë të liruar nga të ardhurat pa marrë parasysh vlerën e dhuratës.
  - Dhuratat e pranuara për qëllime edukative arsimore janë të liruara nga tatimi përderisa dhurata i është dhënë, në formë të pagesës së shkollimit të paguar drejtpërdrejtë, një institucioni edukativ arsimor të pranuar.

Në përgjithësi për shpenzimet

- Shpenzimet e krijuara të cilat janë të lidhura me aktivitetin ekonomik.
- Tatimpaguesit i lejohet zbritje e shpenzimeve nga të ardhurat bruto të bëra në tërësi dhe ekskluzivisht për qëllime ekonomike si dhe disa kufizime të cilat do të sqarohen në vijim.

Shpenzimet afariste te lejueshme

- Zbritjet për shpenzimet nga qiraja, reale ose 10% të qirasë bruto
- Zbritjet për kontributet pensionale
- Zbritjet për shpenzimet që lidhen me të ardhurat mbi shfrytëzimin e pronës së patrupëzuar
- Zbritjet për kontributet bamirëse
- Humbja e bartur
- Zhvlerësimi
- Amortizimi
- Zbritjet e tjera të lejuara- siç është borxhi i keq, shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore.

Shpenzimet e reprezentacionit

- Shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.
- Shpenzimet e reklamës dhe promocionit të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billbordat, reklamat tranzite e të tjera të ngjashme, janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.

Zhvlerësimi

- Çdo vit, asetet e humbasin pjesërisht vlerën e tyre origjinale për shkak të konsumit të tyre qoftë ai fizik apo ekonomik. Kjo humbje e vlerës, përkatësisht ky konsum fizik apo ekonomik që këto asete pësojnë, quhet **zhvlerësim.**

Kategoritë e zhvlerësimit

Kategoria 1	Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore
Kategoria 2	Automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobilet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë; dhe bagëtitë te shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim.
Kategoria 3	Uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet dhe bimët shumë vjeçare dhe shkurret e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave si p.sh. mollët, dardha, arrat, boronicat dhe te tjera; dhe të gjitha asetet e trupëzuara që nuk janë përfshirë në kategorinë 1 apo Kategorinë 2.

Metodat e zhvlerësimit

Metoda lineare - e gjithë prona që zhvlerësohet caktohet në njërën prej kategorive vijuese:

- Kategoria e parë **5%**
- Kategoria e dytë **20%**
- Kategoria e tretë **10%**

Amortizimi

- Mjetet e paprekshme të cilat kanë afat të kufizuar të përdorimit përfshirë patentat, të drejtat e autorit, licencat për vizatime apo modele, kontratat dhe të drejtat ekskluzive, zbriten në formë të detyrueshme të amortizimit.
- Lejimi bazohet në afatin e përdorimit të pasurisë të përcaktuar me marrëveshje ligjore mbi përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme.

Humbjet tatimore

- Ndryshimi negativ ndërmjet të ardhurave të krijuara nga afarizmi dhe shpenzimeve të lejueshme brenda periudhës tatimore.
- Mund të bartet deri në **6** periudha të njëpasnjëshme me akumulim nga viti në vit
- Ruajtja e kronologjisë së krijimit / zbritjes të humbjes

Shpenzimet e qirasë

- Zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë për qind (10%) të qirave të pranuara me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të riparimit, arkëtimit të pagesave dhe të shpenzimeve tjera të paguara apo të krijuara gjatë realizimit të qirasë.

Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja

- Nëse një tatimpagues blen linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anijet, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit, lejohet një zbritje e veçantë prej dhjetë për qind (10%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim (anulim i periudhës kalimtare).

Zbritjet e lejuara për kontribute bamirëse

- Kontributet e dhëna për interes publik (kontributet bëmirëse) lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut.
- Përveç zbritjes së lejuar prej 10%, tatimpaguesit që do të kontribuojnë në fusha të caktuara, do të kenë një lejim shtesë deri në 10% nëse parashihen me ligje të veçanta në Kosovë.
- Zbritja e lejueshme nuk përfshinë kontributin nga i cili direkt apo indirekt përfitojnë donatorët ose personat e afërm me donatorin;

Zbritjet e lejuara për kontribute bamirëse

- Kontributet bamirëse duhet të bëhen për:
  - Një organizatë Joqeveritare.
  - Çdo organizatë tjetër që drejtpërsëdrejti kryen veprimtari jo fitimprurëse që janë të interesit publik, si p.sh: Institucionet mjekësore; Institucionet arsimore; Organizatat për mbrojtjen e ambientit; Institucionet fetare; Jetimoret, etj.

Shpenzimet e palejueshme

- Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të Tokës
- Shpenzimet e mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar
- Gjobat, ndëshkimet
- Tatimi në të ardhura i korporatës
- Tatimi në Vlerën e Shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim
- Çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur nëse nuk është në harmoni me Vlerën e Tregut
- Kontributet Pensionale mbi shumën maksimale të lejuar me ligji

Shpenzimet e palejueshme

- Shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit të cilat janë pjesë e shpenzimeve të përfaqësimit;
- Humbjet, dëmtimet, firot dhe skercot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, përtej normave të përcaktuara në aktet e veçanta ligjore dhe nënligjore;
- Përfitimet në natyrë në formë të shujtës dhe transportit, përveç rasteve kur organizohet nga biznesi;
- Shpenzimet e mbuluara nga grantet subvencionet dhe donacioneve ne harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre.

Evidenca e stoqeve

- Evidenca e stoqeve për çdo tatimpagues
- Më apo para 10 janarit të vitit vijues
- Me çmim të kostos dhe dokumentim mbi origjinën dhe
  - pa TVSh te deklaruesit e TVSh-së
  - me TVSh te jo deklaruesit e TVSh-së

Evidenca e stoqeve

- Janë të aplikueshme metodat:
  - Çmimit mesatar
  - FIFO (I pari brenda – I pari jashtë)
  - HIFO (me I larti brenda – I pari jashtë)
  - Përjashtim LIFO (I fundit brenda-I pari jashtë)
- Kërkesë e veçante për ndërrim metode.

Trajtimi i aktiviteteve të sigurimit

- Kompanitë e sigurimeve të cilat paguajnë 5% e primeve bruto për periudhë tatimore
- Nuk llogarisin Fitim të Tatueshëm (FT)
- Nuk u njihen shpenzimet
- Nuk u njihen rezervat e sigurisë
- Në rast të të hyrave tjera veçante llogarisin FT

Ortakëritë dhe grupimi personave

- Me ortakëri kuptojmë bashkimin e dy a më tepër personave për qëllime biznesi me të drejta dhe obligime të barabarta në kapital, fitim dhe humbje.
- Ortakëritë sipas ligjit obligohen të dorëzojnë deklaratë vjetore ku përfshihen të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e ortakëve, **pa obligim pagese**.
- Ortakëria apo grupimi i personave është përgjegjës për dorëzimin e deklaratave dhe kryerjen e pagesave të të gjitha tatimeve për të cilat ortakëria apo grupimi i personave bëhet i detyrueshëm (si: TVSH, Tatim në Paga, Kontribute Pensionale, Tatim të Mbajtur në Burim, Tatim në Qira, etj).

Ortakëritë dhe grupimi personave

- **Ortakëritë dhe grupimi i personave, si dhe ortakët e ortakërive dhe anëtarët e grupeve**, duhet të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me paragrafin 4 të nenit 33 të këtij ligji dhe secili ortak duhet të paguajnë tatimet në të ardhura obligative në përputhje me paragrafin 2.2 te nenit 43 të këtij ligji.
- **Ortakët** mund t'i shkarkojnë njërën nga deklaratat sipas opsioneve të zgjedhura (IL, QL, PD, CD).

Pagesa e tatimit për veprimtaritë afariste

- Secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë të licencuar nga BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).

Tatimpaguesit me të Ardhura bruto vjetore deri në 50.000€

- **Tre për qind (3%)** të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme ekonomike të çdo tremujori, por jo më pakë se 37.50€ për tremujor.
- **Nëntë për qind (9%)** të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pakë se 37.50€ për tremujor.
- Nëse një tatimpagues nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por tatimpaguesi duhet të dorëzojë deklaratën e kështit tremujor për periudhën edhe kur nuk ka obligim tatimor.

Tatimpaguesit me të ardhura mbi 50,000€

Këstet paradhënie

- Për dorëzimin e kësteve paradhënie, ekzistojnë kritere për:
  - Vitin e parë të afarizmit
  - Vitin e dytë të afarizmit, e tutje

Tatimpaguesit me të ardhura mbi 50,000€

Viti i parë i afarizmit

- **1/4** e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit;
- pagesa në katër këste, ku me pagesën e kështit të katërt mbulon **80%** të obligimit tatimor;

Tatimpaguesit me të ardhura mbi 50,000€

Viti i dytë i afarizmit e tutje

Tatimpagues mund të zgjedhë njërin nga opsionet, si:

- **1/4** e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit, apo
- **110%** të detyrimit tatimor nga viti paraprak të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit.

Tatimpaguesit me të ardhura mbi 50,000€

Përjashtimet:

- Tatimpaguesi i cili krijon humbje nuk ka të drejtë të deklaroi sipas rregullave – opcionit 110% të detyrimit tatimor nga viti paraprak por duhet të deklarojë sikur të ishte viti i parë i afarizmit.
- Tatimpaguesit tek i cili ushtrohet kontrolli tatimor me ç ‘rast ndodh rregullimi i tatimit të atij viti dhe devijimi nuk kalon 20% të shumës së deklaruar nga tatimpaguesi atëherë aplikohet lirimi nga ndëshkimi ndërsa në të kundërtën pason ndëshkimi.

Afatet kohore për deklarim:

Afatet e pagesës së kësteve paradhënie janë deri në çdo 15 të muajit vijues pas çdo tremujori, me sa vijon:

- **TM1/20XX**, nga 01.04.20xx deri 15.04.20xx
- **TM2/20XX**, nga 01.07.20xx deri 15.07.20xx
- **TM3/20XX**, nga 01.10.20xx deri 15.10.20xx
- **TM4/20XX**, nga 01.01.20xx deri 15.01.20xx

- Afati për dorëzimin e **Deklaratës Vjetore** për tatimin në të ardhurat Personale, është nga 01 Janar deri më 31 Mars të vitit pasues të periudhës tatimore.

Funksionimi i Zyrave të Shërbimit të Tatimpaguesve



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ju faleminderit për vëmendje!